



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjqësi  
Mbledhja nr. 18-2008  
Prishtinë, më 09 shtator 2008, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-2003

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi

**Në mbledhje morën pjesë:** Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Kolë Berisha, Riza Smaka, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi dhe Džezair Murati.

**Munguan:** Branisllav Grbiq dhe Lutfi Haziri

**Të ftuar:** Lumnije Murati - ZPRK, Reshit Gashi - NDI, Hysni Ismajli - Departamenti Ligjor KK, Ramadan Islami - OSCE, Fatlum Demiri – AAK, Haxhi Gashi - USAID, Fatbardha Boletini - OSCE, Lejla Selimi OSCE, Jan Meyor – Universiteti i Bremenit

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit, me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 24 qershorit 2008;
3. Shqyrtimi i vendimit të Kuvendit nr.03/859/498-1 të datës 30 korrik 2008 lidhur me riprocedimin e projektligjeve të panëshkruara nga PSSP-ja;
4. Shqyrtimi i projektligjeve me bazë juridike në Kushtetutë;

5. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Gjyqësor të Kosovës nr.51 të datës 03. 07. 2008, për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit Drejtues të IGJK-së;
6. Shqyrtimi i kërkesës së Ndërmarrjes Botuese Rilindja nr.11/8 të datës 07.07.2008;
7. Të ndryshme.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari i njoftoi të pranishmit për propozimin e rendit të ditës:  
*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

#### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 24 qershorit 2008**

**Kryetari** – I pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua me vërejtje nga Riza Smaka rreth pozitive që ka Rexhep Haxhimusa duke shtuar se jo tri pozita, por duhet të jetë dy dhe me këtë ndërhyrje anëtarët e Komisionit e miratuan procesverbalin e mbledhjes së kaluar.*

#### **3. Shqyrtimi i vendimit të Kuvendit nr. 03/859/498-1 të datës 30 korrik 2008 lidhur me riprocedimin e projektligjeve të panëshkruara nga PSSP-ja**

**Kryetari** – I njoftoi të pranishmit për vendimin e Kuvendit lidhur me riprocedimin e projektligjeve të panëshkruara nga PSSP-ja. Diskutuan edhe anëtarët e Komisionit, u formuan nënkomisionet, u caktuan edhe referuesit. Për Projektligjin nr. 2004/31 për të drejtat sendore u caktua nënkomisioni i përbërë nga: Ramadan Gashi, Riza Smaka, Adem Hajdaraj dhe në cilësinë e ekspertit Nerxhivane Dauti, Abdullah Aliu dhe Osman Tmava. Për Projektligjin 2004/40 për avokatinë nënkomisioni përbëhet nga: Selvije Halimi, Muhamet Kelmendi dhe një anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës, ndërsa për Projektligjin nr. 02-L-144 për të drejtat e dhe për përgjegjësitë e deputetit referues do të jetë Kolë Berisha. Për Projektligjin nr. 03-L-002 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhe për Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës referues do të jetë kryetari i Komisionit, po ashtu edhe për Projektligjin e procedurës jokontestimore është formuar nënkomisioni në përbërje: Bahri Hyseni, Ramadan Gashi, Bajram Kosumi dhe Adem Salihaj.

#### **4. Shqyrtimi i projektligjeve me bazë juridike në Kushtetutë**

**Kryetari** – Vazhdoi me pikën e katërt të rendit të ditës me shqyrtimin e projektligjeve me bazë juridike në Kushtetutë dhe të Projektligjit për akreditimin, të Projektligjit për arkivat, të Projektligjit për administratën tatimore dhe të Projektligjit për armët. Kjo pikë e rendit të ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

**5. Shqyrtimi i kërkesës së Institutit Gjyqësor të Kosovës nr. 51 të datës 03. 07. 2008 për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit Drejtues të IGJK-së**

Me rastin e shqyrtimit të kërkesës së IGJK-së për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit Drejtues të IGJK-së kryetari theksoi se duhet të bëhet një shkresë për Zyrën e Kryeministrit dhe për Shoqatën e Prokurorëve të Kosovës.

**6. Shqyrtimi i kërkesës së Ndërmarrjes Botuese Rilindja nr. 11/08 të datës 07. 07. 2008**

**Kryetari** - Këtë pikë të rendit të ditës e hodhi në diskutim dhe u vendos që kjo çështje t'i kalohet Komisionit për ankesa dhe parashtresa dhe për këtë të njoftohet edhe Rilindja me shkresë të veçantë.

**Kryetari** - Diskutoi edhe për Projektligjin për presidentin dhe sqaroi se ky projektligj nuk ka vrejtje në substancë dhe kërkoi që nëse duhet, të përkrahet në parim. Kjo është miratuar nga anëtarët e Komisionit.

**Përfundim**

Komisioni u pajtua në tërësi me formimin e nënkomisioneve dhe të referuesve të projektligjeve, po ashtu njëzëri vendosi për bazën juridike të projektligjeve në Kushtetutë si dhe në parim u dakorduan edhe për Projektligjin për presidentin. Komisioni e shqyrtoi edhe kërkesën e Institutit Gjyqësor të Kosovës nr. 51 të datës 03. 07. 2008 për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit Drejtues të IGJK-së, si dhe kërkesën e Ndërmarrjes Botuese Rilindja nr.11/08 të datës 07. 07. 2008. Komisioni vendosi që vizita në Burgun e Dubravës të bëhet më 17 shtator 2008.

**7. Të ndryshme**

Në pikën të ndryshme u diskutua edhe çështja e avokatit të popullit e ngritur nga Adem Salihaj që kërkoi informatë - si komision - nga Kryesia e Kuvendit. Diskutuesit e tjerë ishin të mendimit se ky komision e ka kryer punën e vet për këtë çështje. Kryetari e shtroi edhe çështjen e vizitës së këtij komisioni në Burgun e Dubravës dhe i pyeti të pranishmit për datën e vizitës. U vendos që kjo të bëhet të mërkurën, më 17. 09. 2008

*Mbledhja përfundoi në orën 12:30*

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni